



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 68, Datë, 12.03.2021

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K., PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3, dhe nenit 16, pika 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/1 prot., datë 04.03.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 403 prot., datë 01.03.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 16, pika 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, përcaktohet si vijon:
Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.
- Referuar sa më sipër, vlefshmëria e licencës nr. 333, Seria F16, dhënë shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., me vendimin e ERE-s nr. 19, datë 16.02.2016, rezulton se ka përfunduar në datën 16.02.2021, ndaj afati i fundit për aplikim nga shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k, për rinovimin e kësaj licence duhet të ishte data 16.12.2020. Nga sa konstatuar, shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. nuk ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës, pasi aplikimi i saj është paraqitur në ERE në datën 01.03.2021.

- Në nenin 10, pika 2, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, përcaktohet si vijon:
Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje, duke plotësuar kërkesat dhe dokumentat e kërkuara në të. Në të kundërt bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurave të shqyrtimit të aplikimit.
- Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. nuk ka përcjellë bashkëlidhur kërkesës së saj asnjë dokumentacion dhe nuk ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, nr. 333, Seria F16, të miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 19, datë 16.02.2016.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI